



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

#### **EKSTRAKT**

**nga Procesverbali i mbajtur më 29 nëntor 2018, në mbledhjen e VIII-të (tetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.20’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Floretë Zejnullahu, ndërsa mungoi Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### **Rendi i ditës**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, e hapi mbledhje, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth rendit të ditës dhe konkretisht për shtimin e një pike të rendit lidhur me kërkesën e komunitetit ashkalinj për zëvendësimin e një anëtari në Komitetit për Komunitete pas vdekjes së anëtarit Shaban Ahmeti. Meqë janë përfillë të gjitha procedurat, ne e kemi marrë këtë propozim nga komuniteti që për anëtar të komitetit në fjalë të propozohet Xhafer Ademi, dhe këtë çështje duhet ta përcjellim për seancën e nesërme si pikë të rendit të ditës, andaj nëse jeni të pajtimit për këtë pikë shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës.

*Njëzëri nga anëtarët prezent (7 anëtar sa ishin për momentin) u miratua pika shtesë e propozuar si pikë e rendit të ditës dhe rendi i ditës në tersi.*

## **1. Propozimi i vendimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës**

**z.Faik Miçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, kemi të bëjmë vazhdim të subvencionimit të shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës, meqë Vendimi i kaluar ka qenë me afat deri në fund të këtij viti. Ndoshta keni vërejtur se me propozimin e ri është një ndryshim i vogël që i është kërkuar Bashkësisë Islame të sjellin raportin e kryerjes së shërbimeve të vërtetuar dhe të nënshkruar nga familjari ose i afërmi i të vdekurit, kjo është bërë për arsyeje të transparencës, të tjerat nuk janë ndryshuar qoftë në çmimore dhe të tjera, kjo është çështje e juaja si e vlerësoni. Mirëpo meqë nuk kemi kërkuar të ndryshojmë asgjë, atëherë ne kemi kërkuar dëshmi sepse mund të ndodh që gjatë një procesi të varrimit nuk kryhen të gjitha shërbimet dhe për me qenë më transparent që çmimet mos të jenë të gjitha fikse atëherë familjari do ta ketë një formular dhe do t'i plotësoj shërbimet të cilat janë kryer, dhe në fund nxirret çmimi real, sepse disa shërbime mund të ndodh të mos kryhen nga Bashkia Islame dhe për këtë kemi bërë këtë ndryshim i cili është në koordinim të plot me Këshillin e Bashkësisë Islame. Nëse keni ndonjë sugjerim do ta pranojmë me kënaqësi nëse jo ju kërkoj që ta përkrahni dhe ta rekomandojmë për Kuvend.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, sa i përket këtij propozimi kam një kërkesë, nëse është e mundur sa i përket shërbimeve të varrimit të hynë edhe hapja e varrit.

**z.Faik Miçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, sqarim parafolësit, kërkesa në fjalë ka qenë edhe para dy viteve mirëpo Bashkia Islame këtë shërbim nuk e ka të rregulluar, përndryshe po ta kishte edhe këtë ata do të duhej të kishin edhe kontraktues, por, duke e parë edhe vullnetin që pothuajse pjesa dërmuese e familjeve që hapjen e varrit ta bëjnë vetë ata, nuk është parë shumë e arsyeshme shërbimi në fjalë dhe kemi rënë në mirëkuptim për shkak edhe të shpenzimeve buxhetore, pra ka mbete që hapjen e varrit ta bëjnë vetë familjarët.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, jam interesuar dhe kamë vërejtur se disa komuna kanë edhe lloje për mirëmbajtjen e varrezave, e në atë rregullore janë të cekura mjaft mirë se si bëhet mirëmbajtja e varrezave pastrimi, hapja e varrit, kush ka të drejtë të varroset në ato varreza në mënyrë që të mos ketë probleme ndërmjet banorëve rreth varrezave, nganjëherë po e ndjej veten keq kur po shkoj në ndonjë varrim edhe po i shoh varrezat e pa pastruara, gjë e cila është keq për vetë institucionin e Komunës pastaj edhe për vet banorët.

**z.Faik Miçiqi**, Drejtor i DSHPMSH, sqarim, ne vazhdimisht jemi duke punuar në infrastrukturë të varrezave që përfshin rrugët deri tek varrezat, rrethojat dhe sipas mundësive viteve tjera do të ketë edhe investime në mirëmbajtje, por kur jemi tek mirëmbajtja duhet të jemi të barabartë për të gjithë sepse nuk mundemi të bëjmë selektive, mirëpo konsiderojmë që është një shumë e madhe e mjeteve financiare sepse kemi shumë varreza. Edhe Këshilli i Bashkësisë Islame nuk ka qenë i gatshme në këtë kohë me pas edhe hapjen e varreve sepse duhet të jetë e kontraktuar nga ndonjë kompani, por tani për tani KBI janë të kënaqur, kështu që në të ardhmen do të shohim mundësi tjera më të mira.

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, sqarim rreth kësaj pike, theksoi, kur është bërë kontrata e parë kam qenë pjesë direkte në këto konsultime. Këshilli i Bashkësisë Islame nuk ka qenë në gjendje të marrë vetë këtë obligim për arsyeje se nuk ka një kompani të kontraktuar, ndërsa prej njerëzve privat është vështirë të paguhen andaj për të mos dështuar nuk është futur në kuadër shërbimeve që duhet të kryhet. Duhet të gjendet një formë e përshtatshme që qytetarët ta kenë sa ma lehtë, mirëpo mendojmë që edhe buxhetin e Komunës mos ta rëndojmë sepse edhe për qytetarët pastaj është një barrë vendosja e një taksë që i mbulon gjithë ato shpenzime.

**z.Fitim Haziri**, pyetje, përse të mos merret ndonjë vendim që Komuna si institucion, përmes një kompanie të mirëmbajtjes varrezat në tërësi në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM, sqarim parafolësit z.Fitim Hazirit, ajo çfarë thoni ju është shumë e mirë për tu bërë, mirëpo ne duhet t'i shohim edhe pozicionimet edhe për varrezat, e që tani dihet që janë në mbyllje, në fakt fjala është për një pjesë të varrezave që janë për qytetin, që do të thotë se vitet e ardhshme, 2019-2020 e tutje pasi të bëjmë ndarjen e parcelave për varrezat e qytetit sikur që ka Prishtina e cila ka ndarë parcela për qytetin dhe mjete financiare për mirëmbajtjen vetëm në qytet por jo edhe në fshatra sepse në fshatra e mirëmbajnë vet banorët. Ne jemi në dijeni që në Komunën e Podujevës kemi 78 fshatra dhe së paku 200 vende të varrezave, kjo për arsye se ka shumë varreza të familjeve, por ne duhet që në të ardhmen të shohim ku kemi hapësira të lira për varreza në fshatra në mënyrë që të kemi një vend të varrezave për një fshat, gjë për të cilën do të bëjmë përpjekje maksimale dhe me këtë besojmë se në të ardhmen të kemi një kompani nga Komuna e cila do të merret me mirëmbajtjen e varrezave, mirëpo këtë nuk kemi mundësi ta ndryshojmë tani pasi që buxheti për 2019 veç është miratuar, por të shohim në vitet e ardhshme a kemi mundësi ta bëjmë këtë. Këshilli i Bashkësisë Islame nuk është i gatshëm t'i kryej këto punë.

*Pas votimit, njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.*

## **2. Propozimi i Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019**

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tera theksoi, kemi të bëjmë me propozim Rregulloren për tatimin në pronë për vitin 2019 e që zakonisht rregullore të tilla viteve të kaluara kanë qenë pjesë përbërëse të buxhetit për atë vit. Forma e tillë nuk aplikuar në këtë vit për arsyeje të ndryshimit të ligjit për tatimin në pronë e që ekskluzivisht pika e cila ka ndryshime është aplikimi i tatimit në tokë, andaj kjo ka ndikuar që ne sot ta shqyrtojmë me vonesë propozim rregulloren në fjalë. Është një tatim i cili po fillon për herë të parë në Kosovë dhe i cili është dashtë të pritët që të hyj në fuqi plotësim ligji për tatimin në pronë i cili që ka hyr në fuqi më 1 tetor 2018, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave konkretisht Departamentin e Tatimit në Pronë, kemi rënë dakord që të mos ngutemi të nxjerrim rregullore deri më 30 shtator siç ka ndodh viteve të kaluara, dhe sërish të kemi pastaj plotësim ndryshim të rregullore për arsyeje se me Qarkoret Buxhetore ata veç i kanë planifikua mjetet të cilat do të vjelën nga ky lloj i tatimit por edhe tatimet të cilat janë vjelë sipas rregullore së kaluar. Tatimi në tokë, mendim i imi personal është se do të ketë vështirësi në aplikim sepse siç e dimë tokat nuk janë të rregullua nga pronarët e ligjshëm, kemi prona të cilat figurojnë në emër të gjyshërve apo të dikujt tjetër, dhe po të kishin në emër të pronarëve do të ishte më e lehtë për të kërkuar që të bëhet inkasimi i tatimit. Ne jemi në dijeni që në këtë aspekt sidomos Podujeva është e theksuar se shumë prona janë edhe në prona të serbëve dhe shfrytëzohen ose nuk shfrytëzohen nga qytetarët e Komunës tonë, andaj do të ketë bukur shumë probleme në inkasim.

Tatimi në pronë në vitin 2019 do të filloj me 20% të vlerës së tokës dhe është paraparë që ky tatim të shkoj me faza deri në pesë vite dhe në vitin e pestë të shkoj në 100% në vlerën e tokës. Pra viti i parë është 20%, viti i dytë 40%, viti i tretë 60%, viti i katërt 80% dhe viti i pestë dikund viti 2023 mendohet që tatimi në tokë të jetë 100%. Gjatë kësaj kohe Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave ka kontraktua firma të licencuara për vlerësimin e pronave në gjithë Kosovën. I njëjti ka qenë edhe në Komunën e Podujevës dhe ka qenë kompania që ka bërë vlerësim dhe ka mbajtur debate me qytetarë duke pas mbështetjen e komisionit komunal të ngritur nga Kryetari i Komunës z.Agim Veliu i

cili ka pasë një shtrirje të gjerë të atij ekipi e që i ka ndihmua kësaj organizate të kontraktuar nga Ministria e Financave që të bëhet vlerësimi i tokave në Komunën e Podujevës. Ne si Ekzekutiv e kemi marrë vlerën apo normën tatimore atë të minimumit që e lejon ligji që për pronat rezidenciale dhe që janë në fuqi aktualisht normën tatimore e kemi propozua 0.15% e që ligji e lejon deri në 1% të vlerës. Norma tatimore te toka është 0.15% minimum i lejuar me ligj, ndërsa maksimumi 0.50%. Tek prona pyjore sërish ne kemi propozua normë tatimore 0.15% minimumi dhe maksimumi shkon deri në 0.30%.

**z.Mehmet Gashi**, theksoi, tek pronat komerciale janë numëruar pronat siç janë, shitore, zyre, restaurant, hotel, andaj çfarë bëhet nëse nuk janë kategoritë apo profesione tjera, shembull, bankat, dyqane tjera, punëtori të ndryshme etj, a do të ishte më mirë të thuhej lokal afarist. E them këtë sepse Komuna i obligon me letra kurse nuk janë në këtë kategori, ta zëmë zyrat, mundet ndokush pastaj të thotë që në Rregullore nuk është e cekur, ndërsa po të themi, lokal afarist, do të përfshiheshin të gjitha. Pra mu duk e pa arsyeshme të numërohen vetëm këto kategori, kurse konsideroj se me termin lokal afarist do të përfshiheshin pothuajse 90% të lokaleve, përndryshe nëse i numërojmë vetëm ato të katërta, bizneset tjera mund të arsyetohen në mos pagim për shkak se nuk janë të përfshira. Pastaj Drejtori i DBF e dinë më mirë, por e ka marrë çmimin e tregut 650 €, unë e di që në qendër ka edhe mbi 1000 € e më shumë, andaj në mënyrë që të mos ju hyjmë në hak qytetarëve, do të kërkoja që mesatarja të jetë më e ulët.

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, sqarim parafolësit, realisht kemi bërë përshkrim më të gjerë, i kemi përmend disa që është e njëjta me atë që është në fuqi tani, në faturë do të jetë pronë komerciale deri tek pika 2.4, çmimi për m<sup>2</sup> do të jetë i njëjti, andaj nuk do të thotë që nuk do të ketë edhe kategori tjera të pronës komerciale të cilat i përmendi parafolësi, por do të jenë të përfshira në këtë çmim prej 650 € m<sup>2</sup> dhe norma tatimore do të jetë e njëjtë për të gjithë. Nuk ka diskriminim këtu është m<sup>2</sup> në pyetje, pra a bëhet fjalë për një kioskë 6 m<sup>2</sup> ta zëmë apo për bankë 200 m<sup>2</sup>, nuk janë të diskriminuar po janë të barabartë për m<sup>2</sup>, kështu që unë nuk e shoh që do të jetë problem kjo çështje. Ndërsa tek pjesa e pikës 2.5, objektet që mund të jenë si ndihmëse në aspektin komercial janë objektet e magazinave, garazheve dhe objekte tjera që e kanë m<sup>2</sup> të diferencuar varësisht prej materialit dhe aktivitetit të cilin e ushtrojnë, dhe është pika 3 ku thuhet prona industriale e që edhe këtu janë përmend disa që janë më të fokusuarat, por sërish është në pyetje m<sup>2</sup> dhe përderisa është m<sup>2</sup> dhe norma tatimore e njëjtë nuk do të ketë diskriminim për askënd.

**z.Mehmet Gashi**, theksoi, i nderuar Drejtorë, mund të jenë prona komerciale që përfshihen të gjitha lokalet afariste, por po ti numërojmë siç janë numërua vetëm katër ose duhet ti numërojmë të gjitha ose duhet me një, që ishte propozim i imi, lokal afarist apo pronë komerciale, ku do të përfshiheshin të gjitha, andaj nëse nuk numërohen të tjerat atëherë mund t'i kontestoj ndokush me arsyetim se biznesi NN që e zhvillon ai nuk figuron askund, pra kjo është sipas mendimit time.

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, të gjitha pronat komerciale qofshin edhe veç 2,4 ose 10 të cilat ne e identifikojmë si afarizm, do të faturohet si pronë komerciale. Mendoj se dallimi është tek objektet ndihmëse të pronave komerciale të cilat kanë vlerë më të vogël për shkak se janë objekte ndihmëse. Secila pronë komerciale, qoftë pronë, kioskë, dhe secila që kryen ndonjë aktivitet komercial, do të tatimohet dhe vlera për m<sup>2</sup> do të jetë 650 € me 0.20% të vlerës tatimore. Për objektet ndihmëse që janë komerciale atëherë vlera për m<sup>2</sup> është e ndryshme por vlerën tatimore prapë do ta ketë të njëjtë. Vlera për m<sup>2</sup> do të jetë më e ulët për shkak se nuk zhvillohet aktivitet parësorë. Ne mund t'i listojmë edhe 10 ose 15 të tjera por në faturë do të jetë pronë komerciale.

**z.Mehmet Gashi**, theksoi, konsideroj se nëse figuron vetëm pronë komerciale dhe përfshihen të gjitha, është krejt në rregull, por nëse i numërojmë, ose duhet t'i numërojmë të gjitha ose mos t'i numërojmë vetëm disa sepse mundet të ketë ndonjë ngatërrim pastaj.

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM-së, theksoj, e mbështes kërkesën e parafolësit z.Mehmet Gashi, përkatësisht tek zyrat, dhe mendoj se nuk ka asgjë të keqe nëse e shtojmë edhe lokale afariste sepse me lokale afariste kemi shumë lloje të bizneseve dhe nëse i çekim disa e disa jo ndokush mundet të thotë nuk është në listë, kurse me kategorizimin si lokale afariste përfshihen të gjitha, andaj do të ishte mirë të shtohet edhe zyre - lokale afariste.

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, e mbështes të jetë si rekomandim, zyre - lokale afariste, mirëpo përderisa paguajmë për prona komerciale 650 € për m<sup>2</sup>, dhe përfshihen të gjitha lokalet – shitoret dhe çdo afarizëm është e arsyeshme, dhe mund ta fusim edhe, zyre - lokale afariste, që të mos kemi dilema. Pastaj në këtë propozim rregullore kemi mund të fusim shumë nene dhe t'i bëjmë kopje prej ligjit dhe akteve tjera por më është dukur se po ngarkojmë shumë, mirëpo si model nga Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë dhe Zyra ligjore e tyre, kemi këtë draft rregullore për të cilën është rekomanduar ti përmbahen të gjitha komunat një modeli të tillë në mënyrë që të mos jenë të ndryshme prej njëra tjetrës. Nëse e marrim këtë propozim rregullore, e njëjta është punuar qysh ne kemi menduar se është më së miri. Ajo çka kemi fut ne, synon që të mos e kemi asnjë pengesë, pastaj të bëhen sa më shumë sqarime dhe të jepen sa më shumë propozime, ide dhe sugjerime, si është rasti konkret ku doli propozimi që të futet termi, zyre - lokale afariste. Në shumicën e shtëpive të banimit hasim në tendencë që një dhomë 4x4 ose 4x6 ta lëmë lokal afarist, mandej në një objekt banimi shtëpi me dimension të njëjtë është lënë objekt afarist, dhe për këtë çdo ditë pothuajse qytetarët ankohen se nuk janë duke punuar në të, dhe po ju tatimohet si objekt afarist. Ligji e rregullon këtë çështje, lokalet të cilat janë të destinuara për afarizëm dhe nuk janë duke punuar tatimohen 70% të vlerës, por nëse vërehet se nuk ka leverdi ekonomike të mbeten si lokal afarist duhet të bëhen objekte banimi, të informohet zyra e tatimit në pronë, të bëhet verifikimi dhe kthehet në dimensione të shtëpisë për banim.

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM, theksoi, nëse është dhënë leja e ndërtimit për lokal afarist dhe dëshiron ndokush të kthehet në banim, paguhet 2.0 € m<sup>2</sup> për tu kthyer sepse shërbimet për lokale afariste janë 2.7, ndërsa për banim është 4.

**z.Isuf Latifi**, drejtor i DBF, theksoj, ne kemi një dukuri që hasim çdo ditë tek regjistrimi i shtëpive, shembull, vetëm tek një familjar edhe pse janë të ndarë, me ligjin që ka qenë në fuqi deri tani, secili objekt i destinuar për banim ka qenë që do të amortizohet menjëherë me 10,000.00€, tani me ligjin e ri vetëm një objekt e fiton të drejtën për amortizim në vlerën prej 15.000.00€, të gjitha të tjerat janë me vlerën reale të objektit 100%. Kjo mundë të ndikoj shumë që të rregullohen dhe t'i bartë secili shumën për objektin e vet. Këtë po e ceku sepse ligjin nuk e lexojnë të gjithë por ne jemi përfaqësues të tyre dhe duhet ti vetëdijesojmë dhe tu tregojmë çfarë përmban ligji sepse kemi raste kur një person i ka disa objekte në emër të vetë e që realisht janë të vëllezërve.

**z.Fitim Haziri**, pyetje, më ka rastisë të shohë që janë bërë pjesë e tatimit 40% tek objektet që janë të pa përfunduara, janë vetëm të filluara dhe për disa vite me radhë mbeten ashtu, andaj a po dëmtohen qytetarët me këtë rast.

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, përgjigje, ligji e rregullon kështu, thuhet, në momentin kur është bërë kërkesa në Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit me projekt për të ndërtuar një objekt dhe është lëshua leja për atë objekt, ai mendohet që nesër do të filloj të ndërtohet. Ato shënime automatikisht barten në Zyrën e tatimit në pronë për tu regjistrua si objekt në punim e sipër, kjo tek ne nuk ndodh të regjistrohet, kjo ndodh vetëm nëse ne e shohim që ai objekt është me kulm, por nëse është vetëm me pllakë, nuk ndodh ta regjistrojmë.

Ligji na obligon secilin prej nesh që në momentin e fillimit të ndërtimit të një shtëpie, atë ta regjistrojmë, dhe po ashtu në momentin që rrënohet një objekt i njëjti të lajmërohet dhe të hiqet nga tatimi. Ka persona që edhe mbas 10 viteve vinë edhe thonë ejani dhe shikoni se ajo shtëpi nuk është më, e që në fakt tani nuk është por para 10 viteve ka qenë, kurse nuk kanë ardhur ta lajmërojnë dhe ta njëkohësisht ta

heqin prej tatimit, mirëpo vijnë edhe bëjnë ankesë ose thonë ejani dhe shikoni, fotografojeni dhe hiqeni nga tatimi. pra kjo është e rregulluar me ligj duam ne apo nuk duam e rregullon ligji.

*Pas votimit, Kuvendit njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me plotësim që në nenin 1 paragrafi 2.2, pas fjalës Zyrë shtohet; dhe lokale afariste*

### **3. Propozim vendimi për shpallje interes publik (ndërtimi i rrugës përgjatë brezit të lumit Llap në Qytet)**

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM, theksoi, më vjen keq që në muajin e kaluar nuk ka kalua kjo pikë me të vetmin qëllim se mua mu kishte dhënë mundësia që të filloj procedurat që sa më shpejt ne t'i kryejmë obligimet ndaj qytetarëve. Kuvendi i Komunës e ka për detyrë të shikoj se a është me interes publik kjo pjesë që është punua apo nuk është interes publik. Çështjet tjera sa i përket procedurave janë çështje të Ekzekutivit të Komunës, dhe ajo çfarë është bisedua me qytetarë deri tani ka shkuar jashtëzakonisht mirë. Unë edhe në mbledhjen e kaluar e kam sqaruar mirë se tri çështje i ka Ekzekutivi pas miratimit të këtij plani. Pastaj unë e kam cekur edhe më parë se nuk në Planin Rregullativ Urban nuk figuron ajo rrugë në tërësi por vetëm një pjesë, andaj edhe kemi qenë të obliguar ta sjell në Kuvend për të ndryshuar ajo pjesë që të futet si proces nga Kuvendi. Atë ditë është diskutuar më shumë se që është dashtë të diskutohet sepse ato janë çështje të Ekzekutivit që duhet procedoj dhe zgjidh më tutje ngase ligji e parasheh një gjë të tillë. andaj edhe njëherë unë kërkoj nga Kuvendi i Komunës që kjo pikë të kalon, me të vetmin qëllim që ne t'i përfundojmë obligimet tjera që i kemi me qytetarët dhe të përfundojmë këtë pjesë urbane.

**z.Fitim Haziri**, pyetje, a është interes publik vetëm rruga apo krejt zona komplet.

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM, përgjigje parafolësit, jo vetëm rruga është paraparë të shpallet interes publik, kurse ajo zonë në të ardhmen është paraparë me hartë zonale të cilën jemi duke e përgatitur për krejt territorin e Komunës së Podujevës. Pra për secilën pjesë të tokës do të parashihet me hartë zonale se çfarë parashihet, dua të them se vlerësimi i pronave është bërë komplet në tërë territorin e Komunës së Podujevës dhe dihet vlera për secilën pronë çfarë çmimi ka, çfarë kategoria e tokës është etj, kurse kjo që ne e kemi sjell në Kuvend është një dokument sipas të cilit ne vetëm dëshirojmë ti hapim rrugën procesit.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, kërkoj një sqarim p.sh aty është caktua që do të behet shpronësimi tek disa banor tash nëse e shohim është një rrugë që nuk i plotëson të gjitha kushtet është e ngushtë në disa vende, pse nuk keni shpronësua më shumë toka që me zgjerua rrugën dhe ti plotësoj kushtet.

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM, përgjigjet, qëllimi i Kuvendit të Komunës është të jap përkrahje këtij propozimi, pastaj pjesa tjetër është e jona si Ekzekutiv që e kemi projektin të kompletuar. Objektet që e pengojnë realizimin e projektit për rrugën në fjalë, do të shpronësohen dhe janë dy objekte të tilla, andaj nuk kemi mundur që ato objekte t'i shpronësojmë pa marr miratimin në Kuvendin e Komunës, andaj nëse miratohet nesër unë menjëherë të hënën i marr hapat e nevojshëm dhe e përgatiti lëndën për ta dërgua në Ministri të Financave ku është ekip e veçantë që bënë vlerësimin e pronave për shpronësim.

**z.Fitim Haziri**, pyetje Drejtorit, kemi dëgjua që ka proces gjyqësor, a ka apo jo.

**z.Hamdi Jaha**, Drejtor i DPUMM, përgjigje parafolësit, janë çështje të pakënaqësive që janë gjithkund por nuk kemi proces gjyqësor. Në qoftë se Ministria e Financave - Departamenti për Vlerësim dhe Shpronësim merr ndonjë pakënaqësi nga qytetarët, atëherë qytetarët kanë mundësi ta dërgojnë lëndën në Gjykatë dhe aty merret një person që ka licencë për vlerësim të pronave dhe del në ballafaqim për

çmimin real të asaj prone, pra kjo është hapi i dytë i ecjes përpara. Po e them këtë për arsyeje se unë jam i licencuar për vlerësim të pronave dhe shpronësim dhe për këtë e di se si shkojnë procedurat.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, ne e rekomandojmë vetëm që duhet të bëhet një sqarim më i saktë në Kuvend me qëllim që mos të dalim në pozitë jo të mirë para qytetarëve sikur ne nuk po duam të ju japim atë kompensim. Ai projekt është në interes publik të krejt Podujevës edhe të atyre qytetarëve, por vetëm se duhet një sqarim dhe mundësisht jo si herën e kaluar ku disa emra të përmendën e disa të tjerë jo, e pastaj të ketë ankesa nga ata se nuk ju përmend emri, por të jenë të përfshirë ata të cilët ju takojnë dhe tu tregohet që është në të mirën e tyre dhe të interesit publik si dhe po ashtu të na ndihmoni edhe neve që ta japim votën ashtu si duhet.

**z.Fatmir Gashi**, theksoi, Drejtori parafolës duhet të sqaroj këtë çështje, dhe për këtë ne e përcjellim në seancën e nesërme të Kuvendit, si dhe të jetë e dijshe se pa u bërë shpronësimi s'mund të bëhet ajo punë, dhe të gjithë ata qytetarë të cilët preken në shpronësime duhet në bazë të ligjit të kompensohen, kjo është në interes publik. Ndodhë shpronësimi kompensohen dhe s'kemi këtu dilema.

*Pas votimit u Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe Miratim.*

**z.Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, ndoshta paksa po dalim prej rendit të ditës sepse nuk ka pikë të ndryshme të paraparë, por kërkoj fjalën një këshilltarë, bëjë përjashtim.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, po i afrohem gati muajit dhjetor dhe e di që janë disa llaptop të pa shfrytëzuar e që janë enkas për këshilltarë të Kuvendit, në mbledhjen e nesërme nuk ka mundësi, por kërkoj që mbledhjen e ardhshme të jemi të pajisur me llaptop, përndryshe unë si Avni Fetahu do ta shikoj mos pjesëmarrjen time në seancë, jo për tjetër, por më duket e pa kuptimit që ata të mbahen në depo e ne të orvatemi nëpër fotokopje.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, edhe unë e mbështes kërkesën e parafolësit, por i shtoj edhe punën e email-ave dhe të id-kartelave, përse ende nuk jemi të pajisura me to.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:15'**

**Procesverbalin e mbajti  
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0093070/18  
Podujevë,  
29 nëntor 2018**

**Kryesuesi i Komitetit  
Fatmir Gashi**